



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 7 Prill 2021

Nr. 205

VENDIM

**PËR SHQYRTIMIN E DENONCIMIT PËR SHKELJE TË PARASHIKUAR NË
NENIN 79 TË LIGJIT NR. 10019, DATË 29.12.2008, “KODI ZGJEDHOR I
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR DHE NË UDHËZIMIN NR. 6,
DATË 23.03.2021 TË KOMISIONERIT SHTETËROR TË ZGJEDHJEVE NDAJ
BASHKISË BELSH**

Objekt: Për shqyrtimin e denoncimit për shkelje të parashikuar në nenin 79 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe në udhëzimin nr. 6, datë 23.03.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve ndaj Bashkisë Belsh

Kërkues: Partia Demokratike e Shqipërisë

Ndaj: Bashkisë Belsh

Baza ligjore: Nenet 19, paragrafi 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, paragrafi 2, dhe 79, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenet 60, 61, dhe vijues të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, udhëzimi nr. 6, datë 23.03.2021 “Për përdorimin e materialeve propagandistike edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore” të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi relacionin e administratës paraqitur nga Sekretari i Përgjithshëm i KQZ-së gjatë procesit të hetimit administrativ,



Data: 7 Prill 2021
Nr. 205

Për shqyrtimin e denoncimit për shkelje të parashikuar nenin 79 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, udhëzimin nr. 6, datë 23.03.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve ndaj Bashkisë Belsh

VËREN:

Në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve është raportuar një denoncim, në ndërfaqen e “Aktiviteteve të Ndaluar”, në rubrikën “Kallëzo”, nga subjekti politik Partia Demokratike e Shqipërisë, për afishimin e materialeve propagandistike nga subjekti zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë, në qytetin e Belshit.

Kallëzimi i paraqitur nga kallëzuesi ruhet në sistem elektronik dhe identifikohet me numër unik të gjeneruar nga sistemi. Në denoncimin e raportuar më datë 19.03.2021, me numër identifikimi të gjeneruar nga sistemi ID nr. 2389, ora 5:23 pretendohet se: *“Në 16 mars, 39 ditë para ditës së zgjedhjeve dhe në pronë publike, janë vendosur materiale propagandistike të Partisë Socialiste e Shqipërisë në qytetin e Belshit, siç tregojnë qartë materialet provuese bashkalidhur këtij kallëzimi”*.

Bashkangjitur denoncimit të kërkuesit janë paraqitur disa fotografi, ku tregohet përdorimi i këtyre materialeve propagandistike nga ana e subjektit zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë.

Sipas përcaktimeve të nenit 23, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve shqyrtoi paraprakisht kërkesat lidhur me kompetencën e organit publik për shqyrtimin e tij.

Referuar nenit 82, e vijues të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve çmon se të dhënat e paraqitura nga kallëzuesi Partia Demokratike e Shqipërisë, përbëjnë indicie të besueshme për të filluar një procedurë administrative.

II.

Rrethanat e faktit

Subjekti zgjedhor “Partia Demokratike e Shqipërisë” ka raportuar në ndërfaqjen e KQZ-së një denoncim me të dhënat e mëposhtme.

Sipas denoncimit nr. 2389 gjeneruar nga Sistemi ID, datë 19.03.2021, ora 5:23 pretendohet se, *“Në 16 mars 2021, 39 ditë para ditës së zgjedhjeve dhe në pronë publike, janë vendosur materiale*



propagandistike të Partisë Socialiste të Shqipërisë në qytetin e Belshit, siç tregojnë qartë materialet provuese bashkalidhur këtij kallëzimi”.

Në datën 06.04.2021 me shkresën nr 3256 prot, Bashkia Belsh i ka njoftuar Komisionit Qendror të Zgjedhjeve vendimin nr. 850 prot. datë 05.03.2021 “Për miratimin e vendeve publike për afishimin e materialeve propogandistike nga subjektet zgjedhore”.

Monitoruesi i caktuar, për monitorimin e përmbushjeve nga subjektet zgjedhore të detyrimeve në lidhje me financimin e fushatës dhe detyrimeve të tjera të parashikuara nga ligji nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, në qytetin e Belshit, në raportin e periudhës 20.03.2021 deri 30.03.2021, ka raportuar vendosjen e materialit propagandistik nga Partia Socialiste e Shqipërisë.

III

Analiza juridike dhe konkluzione

Referuar denoncimit të mësipërm, vendosja e materialeve propagandistike është bërë në një stendë afishimi i quajtur “Kulla panoramike”, e cila është vendosur në qytetin e Belshit. Rezultoi se afishimi i materialeve propagandistike është bërë në “Kullën panoramike”, e provuar nga fotografitë bashkangjitur denoncimit dhe nga raporti i monitoruesit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në Bashkinë e Belshit,

Referuar pikës 1, të nenit 79, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, parashikohet se... *“Jo më vonë se 35 ditë para datës së zgjedhjeve, kryetari i bashkisë, në mënyrë të drejtë dhe të paanshme, përcakton vendet publike në territorin e bashkisë përkatëse për afishimin prej partive politike dhe subjekteve zgjedhore të materialeve propagandistike. Vendet e caktuara duhet të jenë në ambiente që sigurojnë shikueshmëri publike dhe të kenë hapësirë të mjaftueshme ku të gjitha subjektet zgjedhore që marrin pjesë në zgjedhje të paraqesin programet e tyre zgjedhore dhe mesazhet zgjedhore. Vendimi i kryetarit të bashkisë bëhet publik në faqen e internetit të bashkisë menjëherë pas miratimit.*

Kryetari i Bashkisë Belsh, me vendimin nr. 850 prot., datë 05.03.2021 “Për miratimin e vendeve publike për afishimin e materialeve propogandistike nga subjektet zgjedhore”, ka përcaktuar në pikën 1 të tij, miratimin e “Kullës Panoramike”, si vend publik për afishimin e materialeve zgjedhore nga subjektet zgjedhore.

Monitoruesi i caktuar për monitorimin e përmbushjeve nga subjektet zgjedhore të detyrimeve në lidhje me financimin e fushatës dhe detyrimeve të tjera të parashikuara nga ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, në qytetin e Belshit, në raportin e



periudhës 20.03.2021 deri 30.03.2021, ka raportuar vendosjen e materialit propogandistik nga Partia Socialiste e Shqipërisë në vendin publik të përcaktuar nga Bashkia Belsh për subjektet zgjedhore.

Në këto kushte Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi të gjitha provat dhe faktet e paraqitura nga Partia Demokratike e Shqipërisë, në përfundim të hetimit administrativ rezulton se, denoncimi nuk përmban fakte dhe rrethana që të vërtetojnë shkelje të nenit 79 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të nenit 3 të udhëzimit nr. 6 datë 23.03.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, paragrafi 1, shkronjat “dh”, “f”, “n” paragrafi 2, dhe 79, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 60 dhe vijues të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, udhëzimit nr. 6, datë 23.03.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve,

V E N D O S :

1. Përfundimin e shqyrtimit administrativ për arsye se nuk konstatohen elemente të shkeljes së dispozitave të nenit 79, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe nenit 3 të udhëzimit nr. 6 datë 23.03.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.
2. Ky vendin përbën titull ekzekutiv.
3. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen me postë elektronike denoncuesit.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve brenda 3(tre) ditëve nga njoftimi i tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI



Data: 7 Prill 2021
Nr. 205

Për shqyrtimin e denoncimit për shkelje të parashikuar nenin 79 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, udhëzimin nr. 6, datë 23.03.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve ndaj Bashkisë Belsh